

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Maj



01

QENDRA RINORE E SARANDËS HAP DYERT PËR MBI 6,000 TË RINI

Saranda tashmë e ka një hapësirë të re moderne dhe plot jetë për të rinjtë e saj. Më shumë se 6,000 të rinj të qytetit bregdetar do të përfitojnë nga Qendra Rinore Multifunktionale, e kthyer nga një godinë e rrënuar në një qendër zhvillimi personal, profesional dhe krijues. Në ceremoninë e përvitshme të përvitshme, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, e vlerësoi këtë projekt si një përgjigje konkrete ndaj kërkesave të të rinjve të Sarandës: "Kjo qendër është një dëshmi se kur të rinjtë artikulojnë nevojat e tyre dhe institucionet dëgjojnë, ndryshimi është i mundur. Nga një godinë e rrënuar, sot kemi një qendër moderne me sallë leximi, sallë kompjuterash, klub libri, podcast dhe kinema. Tani është radha juaj, të dashur të rinj të Sarandës, ta merrni këtë hapësirë në dorë".

Qendra është ndërtuar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, përmes Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe në bashkëpunim me Bashkinë Sarandë, si pjesë e investimeve për fuqizimin e infrastrukturës rinore në vend. Me këtë investim, Saranda bëhet bashkia e 13-të në Shqipëri ku të rinjtë kanë qendrën e tyre rinore. Qëllimi i këtij programi kombëtar është i qartë: të garantohet një infrastrukturë cilësore për të rinjtë në çdo bashki të Shqipërisë – duke nxitur edukimin, krijimtarinë, bashkëpunimin dhe zhvillimin e potencialit të tyre në çdo fushë.



02

PROJEKTE INOVATIVE NË EDUKIMIN FINANCIAR PËR FUQIZIMIN E TË RINJVE - FIBSAT

Me pjesëmarrjen e rreth 60 nxënësve nga shkollat "Dhaskal Todri" dhe "Teknike Ekonomike" në Tiranë, u përmbyll faza pilot e projektit "Fibsat" – një nismë edukative që i mësoi të rinjve të kursejnë, investojnë dhe menaxhojnë financat përmes një aplikacioni digjital. Në 90% të rasteve, nxënësit zgjedhën të investojnë në llogari kursimi, në vend që të tërhiqnin fitimet – një sinjal i qartë për përvetësimin e sjelljeve të qëndrueshme financiare.

Ministrja Bora Muzhaqi theksoi rëndësinë e projekteve të tilla, që përputhen me objektivin e qeverisë për digjitalizimin e shërbimeve dhe edukimin ekonomik të të rinjve që në moshë të hershme. Projekti u zhvillua në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Fibank Albania, si një model që lidh suksesin shkollor me shpërblimin praktik përmes një platforme interaktive – një hap i ri drejt një brezi më të përgjegjshëm financiarisht.



DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Maj



03

ME PROGRAMET E KODIMIT, MË PRANË VIZIONIT PËR SHQIPËRINË DIGJITALE

Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, së bashku me Kryeministrin Edi Rama dhe zëvendësministren e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Olta Manjani, morën pjesë në aktivitetin përmbyllës të një prej nismave më të rëndësishme për të rinjtë: Programit të Kodimit. Kjo iniciativë synon të përgatisë brezin e ri për tregun global të teknologjisë, duke ofruar trajnime të specializuara në fushën e IT-së dhe programimit.

Përmes kësaj nisme, Qeveria Shqiptare ka subvencionuar kurse profesionale të zhvilluara nga qendra të certifikuara, ku një numër i konsiderueshëm të rinjsh kanë përfunduar me sukses trajnimet intensive. Gjatë fjalës së tij, Kryeministri Edi Rama theksoi rëndësinë e promovimit të këtyre mundësive dhe domosdoshmërinë për t'i informuar të rinjtë mbi potencialin që ato ofrojnë për të ndërtuar një të ardhme brenda Shqipërisë, por të lidhur me tregun global.

Nga ana tjetër, Ministrja Muzhaqi nënvizoi se Programi i Kodimit është një shembull konkret se si aftësitë teknologjike po përkthehen në mundësi reale punësimi. Me 32 kurse të financuara dhe 2,150 të rinj përfitues deri tani, kjo nismë dëshmon qartë se Shqipëria digjitale nuk është vetëm një vizion, por një proces që ka nisur të japë frytet e veta. Të rinjtë shqiptarë kanë sot mundësinë të punojnë për kompani ndërkombëtare pa u larguar nga vendi, duke ndërtuar karriera të suksesshme nga Shqipëria për botën.



04

"GJENERATA E INOVACIONIT" – 11 ZËRA TË RINJ, 11 PROJEKTE QË TRANSFORMOJNË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, mori pjesë në konkursin për shpalljen e projekteve fituese të programit "Gjenerata e Inovacionit". Kjo nismë, e realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës dhe UNICEF Albania, është një hap konkret drejt përfshirjes së të rinjve në modernizimin e administratës publike në Shqipëri. 11 ide novatore, të propozuara nga 11 të rinj, u përzgjedhën për t'u zbatuar në institucione publike, me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare. Këto projekte janë dëshmi e fuqisë që kanë të rinjtë për të gjeneruar zgjidhje të reja përmes teknologjisë dhe inovacionit, duke ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën se si funksionon shteti.

Ministrja Muzhaqi theksoi se ky program është një mundësi unike për të rinjtë jo vetëm për të menduar ndryshe, por për të parë idetë e tyre të bëhen realitet në administratën publike. "Gjenerata e Inovacionit" nuk është thjesht një konkurs, është një platformë për të formësuar një të ardhme më efikase, më transparente dhe më të afërt me qytetarin.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRIA E SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Maj



05

MINISTRJA BORA MUZHAQI NË #EYL40BUCHAREST – DIALOG PËR NJË EVROPË TË QËNDRUESHME DHE DEMOKRATIKE

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, mori pjesë në seminarin ndërkombëtar #EYL40Bucharest, të organizuar nga Friends of Europe, si pjesë e programit European Young Leaders. Nën temën "Si përfundon demokracia (dhe si fillon sërisht)", seminari bëri bashkë liderë të rinj nga e gjithë Evropa për të reflektuar mbi sfidat e demokracisë dhe për të ndërtuar vizione të përbashkëta për Evropën 2035. Në fokus të diskutimeve ishin çështje si rritja e pabarazive, polarizimi politik, si dhe ndikimi i teknologjive të reja, me theks të veçantë të inteligjencës artificiale.

Ministrja Muzhaqi vuri në dukje nevojën për politika të qëndrueshme që mbrojnë vlerat demokratike dhe garantojnë përdorim etik të teknologjisë në shërbim të qytetarit. Ky angazhim ndërkombëtar shënon një tjetër hap të rëndësishëm në përfaqësimin aktiv të Shqipërisë në rrjetet evropiane të lidhshimit rinor, duke forcuar rolin e të rinjve në ndërtimin e një Evrope më të drejtë, më përfshirëse dhe më të përgatitur për sfidat e së ardhmes.



06

TRAJNIMI DYDITOR I EKIPIT TË RINISË - NJË INVESTIM I RËNDËSISHËM NË FORCIMIN E NJOHURIVE MBI METODOLOGJITË E NDJEKURA NGA BASHKIMI EVROPIAN

Ekipi i Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencisë Kombëtare të Rinisë ka përfunduar me sukses trajnimin dyditor mbi Marrëveshjet Ndërkufitare dhe metodologjinë LOD, duke përfunduar njohuritë mbi modelet dhe praktikën e ndjekura nga Bashkimi Evropian në hartimin dhe zbatimin e projekteve për të rinjtë.

Dita e parë u fokusua në temat kyçe të programeve ndërkufitare, si strukturat drejtuese, roli i partnerëve, proceset e aplikimit dhe buxhetimit. Ndërsa dita e dytë solli në vëmendje parimet e metodologjisë LOD – një qasje që garanton cilësinë dhe qëndrueshmërinë e projekteve përmes analizës së rrezikut, monitorimit të zbatimit dhe trajtimit të rasteve konkrete.

Ky trajnim shënon një tjetër hap të rëndësishëm në ndërtimin e një administrate më të përgatitur dhe më të përgjegjshme ndaj të rinjve, duke forcuar kapacitetin për të dizajnuar programe me ndikim real dhe me standarde evropiane në thelb dhe në zbatim.



REPUBLIKA E SHqipëRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRIA E SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Maj



07

NJË SHOQËRI GJITHËPËRFSHIRËSE ËSHTË NJË SHOQËRI MË E FORTË

Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, mori pjesë në konferencën përmbyllëse të projektit "Së Bashku për Barazi", një nismë e zhvilluar nga Open Mind Spectrum Albania dhe mbështetur përmes Agjencisë Kombëtare të Rinisë. Ky projekt synon të fuqizojë të rinjtë dhe të nxisë përfshirjen sociale, me theks të veçantë tek mbështetja institucionale për komunitetin LGBTIQ+.

Me përfshirjen e mbi 7,000 të rinjve në katër bashki të vendit, projekti ka adresuar sfidat sociale dhe ligjore, duke ndihmuar në ndërtimin e një ambienti më gjithëpërfshirës dhe më të sigurt për të gjithë të rinjtë. Pjesëmarrja e institucioneve publike në këtë konferencë është një dëshmi e angazhimit për të ndërtuar politika që garantojnë barazi, pranim dhe respekt për diversitetin. Qasja gjithëpërfshirëse në punën me të rinjtë shihet si thelbësore për forcimin e kohezionit social dhe për krijimin e një shoqërie ku çdo i ri ndihet i vlerësuar dhe i mirëpritur.



REPUBLIKË E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRIA
MINISTRIA E SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT